



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prudato Received / Delivery	01.07.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedimica Org / Unit	Nr Prot Br Proc Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	3872/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.517/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.517/2022 të datës 09.06.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit-Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në çështjen juridike " pezullim parandalues", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.517/2022 të datës 09.06.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 09.06.2022, kanë parashtruar ankesë me numër protokoli 3349/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore, lidhur me vendimin e datës 13.05.2022, për pezullim parandalues, i nxjerr nga Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.06.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Më datë 22.06.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritör ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.517/2022 të datës 09.06.2022, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 13.05.2022, me numër protokollit 32/222, i Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, lidhur me pezullimin parandalues; Akt Emërimi i datës 03.04.2017; Përshkrimi i detyrave të punës; e- maili i datës 13.05.2022; Vendimi i datës 10.06.2022, me numër protokollit 0346, i Komisionit për Ankesa; Vendimi A.nr. 1196/2022, i datës 13.01.2022, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 22.06.2022, me numër protokollit 3638/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, duke u bazuar në shkresat e lëndës të dorëzuar nga palët ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit sepse.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ,bazuar në pretendimin ankimor të ankuesit se me rastin e largimit të përkohshëm nga puna përmes vendimit nr.32/22,të datës 13/05/2022 janë shkelë dispozitat e ligjit të zyrtarëve publik dhe ligjit të punës, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar se pozita „Menaxher i Departamentit Teknik“, sipas Akt Emërimit të datës 03.04.2017, pozitë të cilin e mbanë ankuesi në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror edhe tani, nuk është pozitë e nëpunësit të shërbimit civil, por është pozitë e nëpunësit të shërbimit publik ashtu siç përcaktohet në bazë të dispozitave të nenit 2, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 06/L -114 Për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **“4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike....”**.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me rastin e konstatimit të mësipërm dhe në lidhje me vendimmarrjen për këtë rast me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike sipas detyrës zyrtare me qenë se në lidhje me këto dy lëndë(zyrtarë publik të këtij institucioni) ka vendosur këshilli ka marrë si provë, E-mailin e datës 17.11.2021,dërguar nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në lidhje me lëndën A.nr.857/2021,me që rast informohet këshilli në lidhje me statusin e nëpunësve të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror me që rast është përfshirë në këtë njoftim edhe pozita e ankuesit sipas kësaj ankese respektivisht pozita„ Menaxher i Departamentit Teknik“, ku është konstatuar se kjo pozitë është e Nëpunësit të Shërbimit Publik, poashtu kolegji me rastin e vendimmarrjes në lidhje me këtë rast ka marrë për bazë edhe njoftimin e datës 19/11/2021 nga DMZP-ja, sipas kërkesës së këshillit të të njëjtës datë, në lidhje me lëndën A.nr.1196/2021 që është vendosur në këshill, se me datë 02/03/2021,ka bërë njoftimin për ASHN se të punësuarit në këtë institucion kanë statusin e nëpunësve të shërbimit publik prandaj kolegji bazuar në shkresat e potencuara më lartë dhe bazuar në shkresat e lëndës konstaton se nuk mund të shqyrton ankesën e ankuesit ngase ankuesi nuk ka statusin të Nëpunësit Civil konformë dispozitave Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Bazuar nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2

paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet së: "Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.517/2022, datë 01.07.2022.

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së